

	Republika e Kosovës Republika Kosova–Republic of Kosovo Komuna e Vitisë Opstina Vitina – Municipality of Vitina	
---	---	---

PROPOZIM

RREGULLORE

PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

Qershor 2020
VITI

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 8.5 (pika 8.5.4) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.02-013/778 të datës 07.06.2011, Kryetari i Komunes propozon që në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 si dhe nenit 8.5 të Statutit të Komunës së Vitisë Vitisë Nr.02-013/778 të datës 07.06.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e datës _____2020, të miratojë këtë :

RREGULLORE
MBI TATIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME PËR VITIN 2021

I.DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1
Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore përcaktohen normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme me përjashtim të kategorisë pronë publike brenda kufijve të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme.

II.ZONAT TATIMORE

Neni 2
Zonat tatimore të objekteve

Për vitin 2021, zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për objekte në M² në Komunën e Vitisë caktohen nga Departamenti i tatimit në Pronë:

Në bazë të ligjit 06-L-005, për tatimin në pronën e paluajtshme Kapitulli V neni 17, Ministria e Financave përcakton zonat e vlerave, nivelet e vlerave dhe vlerën e vlerësuar të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunave. Vlerësimi i pronave të paluajtshme kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Ligj dhe në aktin nënligjor që nxjerr Ministria e Financave për kategoritë e vlerave, metodat dhe modelet e vlerësimit.

Po në bazë të këtij ligji këto prona i nënshtohen procesit të vlersimit dhe tatimit:

1. Pronë rezidenciale:
SHTËPI FAMILJARE
APARTAMENT
GARAZH PËR SHFRYTËZIM PRIVAT

OBJEKT TJETËR REZIDENCIAL
2. Pronë komerciale:
SHITORE
ZYRË
RESTORANT
HOTEL
OBJEKT PËR MAGAZINIM KOMERCIAL
GARAZH KOMERCIAL
PISHINË PËR SHFRYTËZIM KOMERCIAL
FUSHË E HAPUR SPORTIVE
FUSHË E MBYLLUR SPORTIVE
POMPË BENZINE
OBJEKT TJETËR KOMERCIAL
3.Pronë Industriale:
FABRIKË
PUNISHTJE
OBJEKT PËR MAGAZINIM INDUSTRIAL
OBJEKT TJETËR INDUSTRIAL

NENI 3.

3.1. ZONA E PARË

QYTETI I VITISË – NËNZONA E PARË A (IA) QENDRA.

Përfshinë shtëpitë, lokalet dhe banesat në këto rrugë:

“Adem Jashari”, “Brigada 173”, “28 Nëntori”, “Rexhep Bislimi”, “Muhamet Muharremi”, “Hoxhë Jonuzi”, “Xhemajl Ademi”, “11 Marsi” dhe “2 Korriku”.

QYTETI I VITISË – NËNZONA E PARË B (IB) . Përfshin shtëpitë,lokalet dhe banesat në rrugët: “Dëshmorët e Kombit”, “Florin Maliqi”, “Lidhja e Prizrenit” ,“Agim Ramadani” , “Kongresi i Manastirit” ,“Idriz Seferi” dhe “Rruga e UÇK-së”,

3.2. ZONA E DYTË

QYTETI I VITISË – NËNZONA E DYTË A (IIA) PERIFERIA DHE FSHATRA.

Përfshinë pronat në rrugët:“Flaka e Janarit”, “Skender Salihu”, “Selami e Mehmet Ismajli”, “Kajolli”, “Sherif Frangu”, “Ylvi Demiri”, “Jeton e Naser Rama”, “Mustaf Shema”, “Safet Ajeti”, “Hebib Sejdiu”, “Hasan Prishtina”, “Elena Gjika”, “14 Qershori”, “Çerqiz Topulli”, “Shota e Azem Galica”, “Nora e Kelmendit”, “Mustafë Koka”, “Nijazi Rexhepi”, “Kemajl Azizi”, “Isa Boletini”, “Nëna Terezë”, “Shabi Kajolli”, “Hasan Kabashi”, “Iliria”, “Safet Rexhepi” “ Remzi Xhaferi” dhe “Daut Zenuni”.

Si dhe shtëpitë dhe objektet afariste të fshatit Pozheran, Radivojcë,Ramjan dhe Budrikë që shtrihen përgjatë rrugës magjistrale Ferizaj-Gjilan. Gjithashtu pronat e fshatit Sadovinë e Jerlive, Drobesh dhe Gërmovë, që shtrihen përgjatë rrugës magjistrale Viti-Gërlicë.

NËNZONA E DYTË B (IIB) PERIFERIA DHE FSHATRAT.

Rrugë të tjera të qytetit, të paemëruara dhe prona të cilat lidhen me rrugët e lartpërmendura, por nuk ju takojnë këtyre emërtimeve, janë rrugë që lidhen me rrugët e nënzonës IIA.

Si dhe fshatrat katastrale: Pozharan, Budrikë, Sadovinë e Jerlive, Radivojc, Ramjan, Droresh, Gërmovë, Kabash, dhe Ramnishtë, duke përjashtua ato shtëpi dhe lokale afariste që bien në Nënzonën IIA

3.3 ZONA E TRETË (III)

Përfshinë këto fshatra katastrale: Beguncë me rruget e saja, Sllatina Epërme, Sllatina Poshtme, Smirë, Terpezë, Trestenik, Zhiti, Katuni i ri, Remnik, Gjylekar, Zhiti, Stublla e Epërme, Goshicë, Letnicë, Vërban, Binçë, Çifllak, Buzovik, Lubishtë, Podgorc, Sodinë e Çerkezëve, Devajë dhe Ballancë.

3.4 ZONA E KATËRT (IV)

Përfshinë këto fshatra katastrale: Debelde, Mjak, Shashare, Vërnez, Vërnakollë, Goden i madh dhe Stublla e Poshtme.

NENI 4 NORMAT TATIMORE

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Vitisë cakton normat tatimore për vitin 2021 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Nr	Lloji i pronës	Norma e tatimit
1.	Prona rezidenciale-shtëpi	0.15%
2.	Prona rezidenciale-banesë	0.15%
3.	Prona industriale	0.15%
4.	Prona komerciale	0.17%
5.	Pronat e braktisura	0.15%
6.	Pronat e papërfunduara	0.15%
7.	Garazhet	0.15%
8.	Pishinat dhe Fushat sportive	0.17%
9	Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15%
10	Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
11	Për njësitë pyjore të parcelave	0.15%

12	Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15%
13	Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
14	Për njësitë komerciale të parcelave	0.17%
15	Për njësitë komerciale të objekteve	0.17%
16	Për njësitë industriale të parcelave	0.15%
17	Për njësitë industriale të objekteve	0.15%

Neni 5

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 01-110/05-1000 e datës 26.09.2019 .

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen Zyrtare të Komunës dhe do të filloj të zbatohet nga data 1 janari 2021.

Arsyetim

Baza ligjore për ta miratuar këtë Propozim - Rregullore është e bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.2 e datës 15 shkurt 2018 si dhe nenit 8.5 të Statutit të Komunës së Vitisë

Nga të cekurat propozohet miratimi i kësaj Rregulloreje.

Rregullorja i dërgohet:

1. *Komitetit për Buxhet e Financa*
2. *Drejtorisë për Buxhet dhe Financa*
3. *Arkivit komunal*

Nr. _____

Komuna e Vitisë , Më _____

KRYETARI I KOMUNËS

Sokol Haliti